

**AKT THEMELIMI I SHOQËRISË TREGTARE**  
**“OSUMI KONSTRUKSION” sh.p.k**

Tiranë, më datë 08/08/2024

**NENI 1**

Shoqëria Tregtare “OSUMI KONSTRUKSION” sh.p.k (në vazhdim Shoqëria) formohet si shoqëri tregtare sipas ligjit 9901 e datës 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” të ndryshuar dhe do të funksionojë në bazë të këtij akti themelimi dhe statutit të miratuar prej saj.

**NENI 2 - EMRI I SHOQËRISË**

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin “Osumi Konstruksion” sh.p.k.

**NENI 3 - OBJEKTI I VEPRIMTARISË**

Shoqëria do të ketë si objekt ushtrimin e të gjitha veprimtarive të mëposhtme: Ne Fushën e ndërtimit, Zhvillimit të pasurive të paluajtshme etj..

**NENI 4 - SELIA E SHOQËRISË**

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Blv. Dëshmorët e Kombit, Kullat Binjake, Kulla 2, kt. 5/4 Tiranë.

**NENI 5 - KAPITALI I SHOQËRISË**

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi i ortakëve themelues të kësaj Shoqërie, në para në vlerën 100.000 Lek. Kapitali ndahet në 2 (dy) pjesë dhe pronësia e kuotave nga ortakët e shoqërisë vijon si më poshtë:

1. Hatixhe Dyrmishi, lindur në Tiranë, më 01/05/1999, shtetase Shqiptar, mbajtëse e pasaportës me nr.BJ5401574, me nr ID J95501052H zotëron 80% të kuotave, e barabartë me një pjesë, me një vlerë të përgjithshme prej (80.000) lekë.

2. Ilir Qafa, lindur në Berat, më 09/06/1978, shtetas Shqiptar, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 033276346 dhe ID H80609066H zotëron 20% të kuotave, e barabartë me një pjesë, me një vlerë të përgjithshme prej (20.000) lekë.

Kapitali themeltar është investuar nga ortakët themelues në total. Vlerësimi dhe pagesa e kapitalit themeltar është kryer nga Ortakët Themelues.

## **NENI 6 - KOHËZGJATJA E SHOQËRISË**

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar. Afati i veprimtarisë fillon mbas regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar.

## **NENI 7 - ORGANET DREJTUESE**

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimmarrës;
2. Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë. Shoqëria do të administrohet nga Administratori, i cilët zgjidhet për një afat pesë vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.

Administratori i parë i Shoqërisë është Ilir Qafa, shtetas Shqiptar, i Lindur në Berat, më 09.06.1978, me nr. personal H80609066H, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me një afat emërimi prej 5 (pesë) vitesh, afat ky fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili i ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

## **NENI 8**

Ekspertët kontabël të autorizuar të Shoqërisë do të emërohen në përputhje me ligjin në fuqi dhe për çdo vit financiar vjetor për veprimtarinë e shoqërisë. Shoqëria do të emërojë ekspertin kontabël.

## **NENI 9**

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

## NENI 10

Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

## NENI 11

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

## NENI 12 - ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis ortakëve apo midis ortakëve dhe Shoqërisë dhe të cilët mund të kenë si objekt të drejta si rrjedhim i raporteve të tyre me shoqërinë do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.


## NENI 13 - DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Akt i Themelimit hartohet në 5 (pesë) kopje në gjuhën shqipe.

### ORTAKËT

Ullir Qafa

(emer, mbiemer, firme)



Hatixhe Dyrmishi

Hatixhe Dyrmishi

(emer, mbiemer, firme)

